



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me Nenin 1 pika 1.7 paragrafi d të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, me qëllim të funksionimit më efikas të strukturave organizative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i MPMS-së nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.5/2003
PËR
(RIORGANIZIMIN) E INSTITUTIT TË POLITIKËS SOCIALE

Neni 1

Organizimi i institutit

1.1 Me këtë udhëzim administrativ, organizohet **Instituti i Politikës Sociale (tash e tutje Instituti)**, si institucion i pavarur, (në nivelin e Departamenteve të tjera), për punën dhe aktivitetet profesionale nga fusha e mirëqenies sociale.

Neni 2

Misioni i institutit

2.1 Misioni i Institutit është studimi, analiza dhe zhvillimi i marrëdhënieve të reja, në fushën e mirëqenies sociale, pastaj publikimi periodik i rezultateve të hulumtuara për çështjet sociale si dhe ofrimi i informacionit për nivelin e ngritjes profesionale të personelit i cili punon në shërbimet sociale.

Neni 3

Metodat e zbatimit të misionit

- 3.1.** Metodat dhe mjetet për zbatimin e misionit të Institutit janë:
- Realizimi i studimeve dhe analizave të ndryshme nga fusha e mirëqenies sociale.
 - Realizimi i botimeve dhe publikimeve nga studimet dhe analizat e arritura shkencore.

- Shërbimet konsulente për klientelën e Institutit.
- Organizimi i seminareve dhe konferencave.
- Organizimi i tryezave të ndryshme dhe
- Komunikimi e bashkpunimi me strukturat organizative të MPMS-së, e në veçanti me DMS-së për ngritjen profesionale të stafit të MPMS-së.

Neni 4

Funksionet e institutit

4.1 Fushëveprimtaria e Institutit është:

- Puna dhe aktivitetet studimore, hulumtuese dhe analitike e dukurive dhe çështjeve nga fusha e mirëqenies sociale sipas standarteve bashkëkohore ndërkombëtare.
- Gjurmimi dhe hulumtimi i problemeve në segmentet e caktuara të shërbimeve sociale dhe familjare.
- Ofrimi i shërbimeve dhe ndihmës profesionale MPMS-së dhe institucioneve të tjera të mirëqenies sociale.
- Promovimi i njohurive profesionale, shkathtësive dhe ngritjes së cilësisë së punës të institucioneve përkatëse të mirëqenies sociale.
- Licensimi dhe regjistrimi i ekspertëve profesionalë që punojnë në shërbimet sociale dhe familjare.
- Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve për përparimin dhe zhvillimin e sistemit dhe koncepteve nga mirëqenia sociale.
- Këshillimi dhe rekomandimet profesionale për MPMS-në, DMS-n[dhe QPS-në, dhe
- Punë të tjera të përcaktuara me akte normative.

Neni 5

Mbikëqyrja, drejtimi dhe menaxhimi i institutit

- 5.1.** Punën dhe zhvillimin e aktiviteteve të Institutit e mbikqyr Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- 5.2** Aktiviteti i përgjithshëm i Institutit drejtohet nga Drejtori, i cili së paku një herë në vit, për punën e institutit, raporton me shkrim tek Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- 5.3.** Për menaxhimin e punës profesionale dhe aktiviteteve të tjera, formohet Bordi Menaxhues i Institutit, i emruar nga Ministri i MPMS-së.

5.4.Antarët e Bordit Menaxhues, duhet të jenë nga Qeveria e Kosovës, Shoqëria Civile dhe Institucionet e Arsimit dhe të Shkencës

5.5.Zgjedhja dhe rekrutimi i Drejtorit, do të bëhet sipas procedurës së zakonshme, e paraparë për nënpunësit e Shërbimit Civil të Kosovës.

5.6.Lidhur me përbërjen, kompetencat, strukturën dhe numrin e antarëve të Bordit Menaxhues, Drejtori i Institutit, Ministrit të MPMS-së i propozon Rregullore të veçantë për miratim.

5.7.Për rregullimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të Institutit, Ministri i MPMS-së mund të nxjerrë rregulla të tjera juridike deri në miratimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Neni 6

Financimi i institutit

6.1 Veprimtaria e Institutit do të finanohet nga Buxheti i Ministrisë së punës dhe Mirëqenies sociale.

6.2. Me kalimin e kohës, duke siguruar shërbime të caktuara për institucione përkatëse, Instituti mund të vetëfinanohet.

Neni 7

Hyrja në fuqi

7.1. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga 01.01.2004, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Prishtinë, Janar 2004

**Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi**

Ndërtesa e re e Fakultetit Ekonomik
Prishtinë,

Neë building of economic faculty
Prishtina
Tel. 038/244 228, Fax.038/244 229

Zgrada novog ekonomskog fakulteta
Priština